



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Pranuar / Prilbena më Datë 08-01-2026			
Nr. Llogarit Org. Broj	Nr. Broj	Shtetësi Përfaq.	Vlera Vendos
01	110	05	70



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2 shkronja d, nenit 41, paragrafët 41.1 dhe 41.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), Udhëzimit Administrativ Nr.2009/01, për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësit e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, nenit 29 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/49, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 08.01.2026, miraton këtë:

V E N D I M

Për zgjedhjen e Kryesuesi të Kuvendit të Komunës së Vitisë

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Neni 2

Kryesuesi i Kuvendit, sipas nenit 1 të këtij vendimi, zgjidhet Bekim Azizi nga fsh. Smirë Komuna e Vitisë.

Neni 3

Mandati i kryesuesit zgjatë katër vite, respektivisht deri në inaugurimin e Kuvendit të ardhshëm, në pajtim me depozitat e Ligjit për Zgjedhjet Lokale në fuqi.

Punët dhe detyrat e kryesuesit të Kuvendit janë të parapara me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40, Udhëzimit Administrativ Nr.2009/01, për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësit e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës dhe Statutin e Komunës së Vitisë.

Neni 4

Paga e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Vitisë do të caktohet sipas legjislacionit në fuqi, për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Financa.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 10, pika 6 të Ligjit për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Nr. 08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27 Dhjetor 2024), dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Kryesuesit të Kuvendit,
2. Kryetarit të Komunës
3. Drejtorisë për Financa
4. MAPL-së;
5. Arkivit

KRYESUESI I SEANCES SE KUVENDIT

Basri Aliu